



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LUSHNJE  
ZYRA E MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 1366 Prot.

Lushnje më, 15/02/2023

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË PASURIVE ME NR. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9, 169/7, 169/45, 169/8 DHE 169/52, TË NDODHURA NË ZK. 1020, FSHATI ALLPRENAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOLEM.”**

**Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë !**

Në inventarin e pronave te paluajtshme shtetërore të miratuara me VKM-në nr. Nr.818, datë 29.11.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Golem, të Qarkut të Fierit”, sot Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, pasuritë me nr. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9/7, 169/45 dhe 169/8, të ndodhura në ZK. 1020, fshati Allprenaj, janë të transferuara në përdorim sipas lidhjes nr. 1, me nr. rendor 153, me specifikimin “Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë bujqësore”, ZK. 1020, Indeksi i hartes K-34-112-23-C, e llojit tokë arë, me sipërfaqe përkatësisht 2687 m<sup>2</sup>, 1375 m<sup>2</sup>, 11812 m<sup>2</sup>, 9625 m<sup>2</sup>, 7625 m<sup>2</sup> dhe 3375 m<sup>2</sup>, Fusha e përdorimit të pronës është Bujqësi, Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative është Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Institucioni/Enti përdorues është ish Komuna Golem, sot Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje.

Pasuria me nr. 169/52, ZK. 1020, fshati Allprenaj, në inventarin e pronave te paluajtshme shtetërore të miratuara me VKM-në nr. Nr.818, datë 29.11.2007, është e transferuar në përdorim, me nr. rendor 80, ZK. 1020, Indeksi i hartes K-34-112-23-C, e llojit karrierë, me sipërfaqe 11000 m<sup>2</sup>, Fusha e përdorimit të pronës është Zhvillim ekonomik, Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative është Ministria e Industrisë dhe Energjitikës dhe Institucioni/Enti përdorues është Komuna Golem.

Me shkresën nr. 270 prot. datë 26.06.2002, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot DVASHK Lushnje), Këshilli i Qarkut Fier bazuar në kërkesën e Komunës

Golem, ka berë ndryshimin e zërit kadastral nga tokë arë në karrierë për pasuritë me nr. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9, 169/7, 169/45, 169/8.

Pronat janë regjistruar në DVASHK Lushnje, e cila na ka dërguar kartelat e pasurive, ku te kartelat ka venë shënimin “Në Përdorim të Bashkisë Lushnje”. Për pasuritë e mësipërme ishte lidhur kontratë qiraje me Ish Komunën Golem dhe Shoqërinë Volalba sh.p.k. me nr. 5645 rep., nr. 2069 kol, datë 05.07.2006, nëpërmjet se cilës afati i kontratës së qirasë ishte deri në datën 31.12.2020.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, shkresën nr.23781/3 prot., datë 02.02.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe V.K.M-në nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera dhe enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, kreu 1, pika 7, ku përcaktohet se “Të drejtën e lidhjes së kontratës së enfiteozës për pasuritë shtetërore, me afat deri në 20 (njëzet) vjet, e ka ministria përgjegjëse për ekonominë ose organi i qeverisjes vendore, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit mbi pronën”, që në rastin konkret është Këshilli Bashkiak Lushnje.

Propozojmë , miratimin e fillimit të procedurave ligjore për dhënien me qira të pasurive me nr. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9, 169/7, 169/45, 169/8 dhe 169/52, të ndodhura në ZK. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem për një afat 20 (njëzetë) vjeçare.


Bashkëlidhur:

- Kartelat shoqëruar me fragmentet e hartës për pasuritë me nr. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9, 169/7, 169/45, 169/8 dhe 169/52 nga DVASHK Lushnje.
- VKM-në nr. Nr.818, datë 29.11.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Golem, të Qarkut të Fierit”, sot Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, lidhja nr. 1 dhe fleta e inventarit.
- Kontratë qiraje me nr. 5645 rep., nr. 2069 kol, datë 05.07.2006.
- Gen-Planet për pasuritë me nr. 169/50, 169/12, 169/44, 169/9, 169/7, 169/45 169/8 dhe 169/52.

Faleminderit për mirëkuptimin !

**Konc:** L. Murati

S. Manoku



**KRYETARI I BASHKISË  
ERISELDA SEFA**

